

MINISTRIA E BRENDSHME
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
PRILL - QERSHOR 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarif a
11	27.03.2024,	Kërkesë për informacion nga një OJF në lidhje me “dokumente të përgjithshme të institucionit MB” dhe për “dokumente specifike të akteve të konsultuara”	19.04.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, bashkëlidhur ju dërgojmë përgjigjen e përgatitur nga drejtoria përkatëse, në format PDF, (17 faqe gjithsej) si dhe dokumentet e tjera si “raport vjetor”, “tabelë komentesh”, “raport 6 mujor”, “indikatori i performancës” etj, (6 dokumente gjithsej).	E plotë	Nuk ka
12	12.04.2024	Kërkesë për informacion nga një gazetarë në lidhje me një marrëveshje (protokoll) me vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor për tregun e punës.	30.04.2024	Lidhur me pyetjen 1 dhe 2: Protokollin ndërmjet Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut për zbatimin e “Marrëveshjes mbi kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor”, i nënshkruar më 22 janar 2024, do të miratohet me VKM në Këshillin e Ministrave në përputhje me nenin 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, hyn në fuqi menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare, dhe nuk i nënshtrohet procedurave të ratifikimit në Kuvend. Lidhur me pyetjen e 3: “Faza e përgatitjes së faqes online për aplikimin e qytetareve për akses të lirë në tregun e punës”,	E plotë	Nuk ka

				institucioni përgjegjës është AKSHI. CC: Komisioneri për të Drejtën e Informimit		
13	17.04.2024	Kërkesë për informacion për kopje dokumentesh zyrtare nga një OJF.	02.05.2024	Në përgjigje tuajës, mbi komunikimin e zhvilluar në lidhje me projektligjin “Për prefektin e qarkut”, bashkëlidhur ju dërgojmë në format elektronik dokumentet e mëposhtme: 1- Urdhri i Ministrit të Brendshëm për ngritjen e grupit të punës 2- Kopje të Procesverbali të Këshillit Konsultativ 3- Tabela e konsultimit publik për prefektin e qarkut 4- Vendimi nr. 5, datë 25.10.2023, i Këshillit Konsultativ (dy vendime) 5- Mendimet e ministrive të Drejtësisë, Mbrojtjes, Arsimit, Financave & Ekonomisë (4 shkresa) 6- Vlerësim - RIA e projektligjit për prefektin - Drejtoria e Ndikimit Rregullator 7- Komentet nga Shoqata për Autonomi Vendore (gjithsej – 11 dokumente).	E plotë	Nuk ka
14	22.04.2024	Kërkesë nga një shtetase për "relacionet përfundimtar e të VKM-ve të miratuara gjatë muajit janar 2024, me propozim të Ministrit të Brendshëm"	02.05.2024	Bashkëlidhur ju dërgojmë 4 (kater) relacione, (nr. 122, 123, 124, 134) te përcjella nga Drejtoria Juridike. Pjesen tjetër do t'jua përcjellim sapo të kemi në dispozicion materialin nga strukturat perkatese.	E plotë	Nuk ka
15	22.02.2024	Kërkesë për informacion	21.05.2024	Gjatë vitit 2023 janë realizuar ndërhyrje	E plotë	Nuk ka

		nga një gazetare në lidhje me zjarret në banesa për vitin 2023		operacionale të shërbimit të MZSH në nivel vendor, nga të cilat 1,093 kanë qenë zjarre në zonat urbane.		
16	22.05.2024	Kërkesë nga një gazetare për info mbi numrin e fëmijëve 0-6 vjeç në bashkinë Tiranë	27.05.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se bazuar në të dhënat e Gjendjes Civile, janë 61,610 fëmijë të moshës 0-6 vjeç, në bashkinë Tiranë.	E plotë	Nuk ka
17	22.05.2024	Kërkesë për informacion nga një gazetare mbi numrin e kërkesave për shtetësi, trendin, origjinën etj.	07.06.2024	Ju bëjmë me dije se: Dekrete per fitim te shtetesisë shqiptare, ndare sipas viteve jane: 2021 - 358 dekrete fitimi; 2022 - 446 dekrete fitimi; 2023 - 347 dekrete fitimi 159 për vitin 2024 Trendi i kërkesave sipas vendeve janë: Kosova Turqia.	E plotë	Nuk ka
18	20.05.2024	Kërkesë për informacione në lidhje me procesin e vetingut në Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera të varësisë.	10.06.2024	Ju dergojme pergjigjen e detajuar nga AMP: "Ligji për vlerësimin kalimtar e periodik, gjatë zbatimit dhe implementimit të tij ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, përkatësisht në vitin 2019, 2020, 2021 dhe në vitin 2022. Ligji fillestar nr.12/2018, parashikonte Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, si organin përgjegjës për vlerësimin kalimtar të punonjësve Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish-SHÇBA), duke kryer një proces të plotë për kontrollin e pasurisë,	E plotë	Nuk ka

				figurës dhe aftësive profesionale. Në ndryshimet ligjore të ndodhura në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik. Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik, ose siç njihet ndryshe vettingu, ka për objekt vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në zbatim të Ligjit nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si institucioni		
--	--	--	--	---	--	--

				përgjegjës për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, si dhe Udhëzimit nr. 07, datë 17.01.2023, të Ministrit të Brendshëm, “Për procedurat dhe mënyrën e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit...”, më datë 05.04.2024 dhe më datë 04.07.2023 ka hedhur dy shorte, me nga 36 subjekte për secilin short. Aktualisht Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, po zhvillon procesin e vlerësimit kalimtar për 72 subjektet e vlerësimit dhe deri tani janë marrë gjithsej 35 vendime, nga ku: - 4 punonjës të AMP-së në momentin e hedhjes së shortit, - 2 punonjës të Gardës së Republikës në momentin e hedhjes së shortit, - 29 punonjës të Policisë së Shtetit në momentin e hedhjes së shortit. Për sa më sipër, nga 29 vendimet për punonjësit e Policisë së Shtetit, ka rezultuar; - 1 Vendim për Përfundim nga Detyra të subjektit të vlerësimit - 1 Vendim për Largim nga Pozicionet e përcaktuar në nenin 6, të ligjit nr. 12.2018, i ndryshuar, - 7 Vendime për Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar, - 20 Vendime për konfirmim në detyrë të subjektit të vlerësimit.		
--	--	--	--	---	--	--

				Gjithashtu ju informojmë se po zhvillohet hetimi administrativ në kuadër të procesit të vlerësimit kalimtar për 37 subjekte vlerësimi." Informacionin e mesiperm te AMP mund ta konsultoni ne çdo kohe ne faqen e AMP, ne rubriken perkatese qe e gjeni ne linkun pasues: https://amp.gov.al/vendime/ Informacione ne lidhje me nisjen e procesit te vetingut dhe vendimet e marra nga Komisioni i Jashtem i Vleresimit (KJV) mund t'i gjeni ne faqen e Ministrise se Brendshme, ne linkun vijues: https://mb.gov.al/te-dhena-39-vendime-te-trupave-te-kjv-nga-nisja-e-detyres/ Të dhëna – 57 vendime të trupave të KJV në total: ⇒ 40 konfirmime në detyrë; ⇒ 5 përjashtime nga detyra; ⇒ 6 zyrtarë janë dorëhequr nga detyra; ⇒ 1 proces i ndërprerë, pasi zyrtari doli në pension pleqërie; ⇒ 2 proces në gjykim, në pritje të vendimit; ⇒ 2 detyrim për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm pranë Akademisë së Sigurisë;		
--	--	--	--	--	--	--

				⇒ 1 lirim nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA-së, konstatohet rast i papajtueshmërisë me funksionin. CC: Komisioneri për të Drejtën e Informimit		
19	02.06.2024	Kërkesë për informacion nga një gazetar në lidhje me përdorimin e të dhënave vizuale përmes satelitëve “Albania 1” dhe “Albania 2”, për të zbuluar ndërtime të paligjshme apo kundërvajtje të tjera	10.06.2024	Ju bëjmë me dije se IKMT, deri më sot, nuk ka përdorur ende informacionet nga satelitët, edhe pse bashkëpunon ngushtë me ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor). Aktualisht IKMT është në fazën e trajnimit të inspektorëve të vet dhe të testimit të sistemeve të reja për përdorimin e imazheve nga satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2”. Nëpërmjet sistemit Arc-GIC online, IKMT-së i është dhënë mundësia që të përdorë imazhet satelitore për inspektimin e mjedisit, ujërave, pyjeve dhe ndërtimeve, me fokus të veçantë vijën bregdetare. Për çdo kërkesë specifike të IKMT, ASIG përgatit grupin e punës për përpunimin e të dhënave satelitore, sidomos në raste kur aksesimi i terreneve është i vështirë apo i pamundur.	E plotë	Nuk ka
20	05.06.2024	Kërkesë nga një gazetar për “Raporti mbi Popullsinë sipas	20.06.2024	Bashkëlidhur ju dërgojmë materialin në format “excel”, me të dhënat sipas Regjistrat Kombëtar Civil, të përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e	E plotë	Nuk ka

		Regjistrit Civil të ndarë sipas Qarqeve dhe Bashkive për vitin 2023 (gjendja 1 janar 2024)”		Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme. Në përmbushje të kërkesës suaj, këtë përgjigje po jua dërgojmë me email.		
--	--	---	--	--	--	--